



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	21/10/2024
Nr.	3032

**KOMISIONIT RREGULLATOR**

Këtu

Të nderuar anëtarë të Rregullatorit,

Marrë në konsideratë sa diskutuar nga ju në mbledhjen e datës 18 Tetor 2024 mbi projektvendimin “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, më lejoni të tërheq propozimin për shqyrtimin nga ana juaj të këtij projektvendimi dhe jeni të lutur ta shqyrtoni të ripunuar këtë draft, i cili ju ripropozohet si projektvendimi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

Drafti i ripropozuar ka reflektuar disa prej mendimeve të prezantuara nga ana juaj në seancën e datës 18 Tetor 2024.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, ju urojë punë të mbarë

**Ilirjan Celibashi**

**Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**





Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

## **RELACION**

### **PËR**

### **PROJEKTVENDIMIN**

### **PËR**

## **MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË** **VENDIT DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE**

### **I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projekaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit.

Neni 25, pikat 1 dhe 12, të Kodit Zgjedhor parashikojnë se zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij Komisioni Rregullator, me propozimin e Komisionerit, miraton aktet e nevojshme normative nënligjore për përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, mënyrën dhe afatet e komunikimit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe eventualisht bazë tjetër të dhënash, si dhe modalitetet dhe rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste. Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Pas hapjes së procesit të regjistrimit nga KQZ-ja zgjedhësi aplikon në mënyrë individuale për regjistrim në listën e këtyre zgjedhësve. KQZ-ja krijon, mirëmban dhe përditëson platformën elektronike për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve që dëshirojnë të votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zgjedhësi për regjistrim në listë paraqet dokumentacion që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 46, pika 3 i Kodit Zgjedhor parashikon se lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të KZ.

## **II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend, me qëllim garantimin e të drejtës së votës të çdo shtetasi shqiptar që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në datën e zgjedhjeve.

Projektakti rendit parimet, të cilat janë shtyllat ku do të mbështetet procesi i regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë vendit. Përfshirja e tyre në projektakt erdhi si sugjerim i organizatës Diaspora për Shqipërinë e Lirë. Ndërkohë u reflektua edhe propozimi i Partisë Demokratike për të përfshirë fjalën ‘gjithëpërfshirjes’ në parimin e katërt. Në kreun I të projektvendimit parashikohen si më poshtë vijon:

- 1. Parimi i transparencës: Procesi i regjistrimit dhe votimit për zgjedhësit jashtë vendit duhet të jetë i hapur dhe i monitoruar në mënyrë që të garantohet informimi i duhur i publikut dhe subjekteve zgjedhore mbi çdo hap të procedurave.*
- 2. Parimi i thjeshtësisë dhe lehtësisë: Procedurat e regjistrimit dhe të votimit për zgjedhësit jashtë vendit duhet të jenë të thjeshta dhe të lehta për t'u kuptuar e ndjekur nga zgjedhësit, duke minimizuar barrën administrative dhe teknike.*
- 3. Parimi i efektshmërisë: Procedurat për regjistrimin dhe votimin nga jashtë vendit duhet të jenë efektive, duke synuar që vota e çdo shtetasi të realizohet në kohë dhe pa pengesa të panevojshme.*
- 4. Parimi i gjithëpërfshirjes dhe aksesit të barabartë: Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, pavarësisht vendndodhjes së tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të ketë mundësi të barabarta për të votuar.*
- 5. Parimi i diskrecionit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda kufijve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Diskrecioni ushtrohet në mënyrë që të përmirësohen proceset dhe të adresohen situata të paparashikuara për të garantuar realizimin e votës.*

Në kreun II parashikohen rregulla të përgjithshme të përcaktuara në Ligj sa i takon procesit të regjistrimit të zgjedhësve dhe institucionit kompetent për të administruar këtë proces, ku përcaktohet se regjistrimi i zgjedhësit në listën e zgjedhësve jashtë vendit bazohet në vullnetin e vetë zgjedhësit për ta ushtruar të drejtën e votës jashtë vendit. Regjistrimi në listën e zgjedhësve jashtë vendit passjell ç' regjistrimin e tij nga lista e zgjedhësve që votojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në kreun III parashikohen rregulla të posaçme që lidhen me paraqitjen e kërkesës për regjistrim, afatet dhe dokumentacionin shoqërues që do të duhet të plotësojë zgjedhësi nga jashtë vendit.

Referuar nenit 25, pika 4, 5 të Kodit Zgjedhor, kërkesa për regjistrim bëhet në mënyrë individuale nga zgjedhësi dhe kjo kërkesë i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas procedurave

të parashikuar në këtë vendim. Afati për paraqitjen e kërkesës fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 68 ditë para kësaj date. Hapja e procesit të hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit dhe regjistrimin e tyre bëhet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të këtij procesi. Është parashikuar që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ta lajmërojë publikisht fillimin e këtij procesi të paktën 10 ditë përpara se ky i fundit të nisë si kohë e mjaftueshme për zgjedhësit jashtë për të marrë ndërkohë të gjithë informacionin e duhur sesi do të bëhet regjistrimi, sa kohë ka për ta bërë atë si dhe të sigurojë ndërkohë dokumentacionin e duhur. Kërkesat për regjistrim në zbatim të parashikimeve të nenit 25, pika 5 të KZ, bëhen në platformën elektronike e cila krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga KQZ. Propozimi për ta patur këtë platformë në të dy versionet mobile dhe desktop si dhe për të qenë pa pagesë për zgjedhësit bëhet për të ulur barrën e kostos tek zgjedhësi si dhe për të rritur aksesueshmërinë për këdo në mënyrë që të mos jenë të varur nga teknologjia që gjithsecili disponon.

Fillimisht, zgjedhësi krijon një llogari në *Platformën Elektronike të Regjistrimit*, (referuar si “PER”) e cila krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga KQZ. PER duhet t’i përcjellë sqarime zgjedhësit në lidhje me procedurat e regjistrimit në listën e zgjedhësve jashtë vendit, si dhe mbi kushtet e kriteret për ushtrimin e të drejtës së votimit nga jashtë vendit. Karakteristikat e përgjithshme teknike të PER si dhe rregulla të përgjithshme të përdorimit të tij përcaktohen në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Në çdo rast struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zhvillimin e procedurave përcakton specifikimet teknike për prokurimin e PER.

Paraqitja e kërkesës për regjistrim në PER bëhet duke krijuar një llogari në këtë platformë nga vetë zgjedhësi, krijimi dhe hyrja në vijim sipas rastit bëhet nëpërmjet përdorimit të tre faktorë autentifikimi. Një prej faktorëve autentifikues duhet të jetë biometrik me njohje të fytyrës, kod unik 6 shifror që i dërgohet në numrin e telefonit mobil dhe/ ose email, si dhe faktori i tretë është Numri Personal i Identifikimi (NID) i zgjedhësit dhe fjalëkalimi. Kjo mënyrë aksesimi është propozuar për të ofruar siguri në një të kënaqshme e për tu siguruar se vërtet kërkesa bëhet nga zgjedhësi vetë. Ai/ajo disponon numrin personal ashtu sikundër do duhet të shfaqet vetë personalisht përpara kamerës e cila duke aplikuar teknologjinë ‘liveness’ konstaton se përpara ekranit është vërtet nje person dhe jo një foto e tij/saj dhe së fundmi verifikimi përmes kodit unik të përkohshëm që gjenerohet sa herë ky i fundit kërkon akses dhe që disponohet vetëm nga zgjedhësi pasi i dërgohet njëkohësisht në numrin celular të deklaruar nga ai vetë si dhe në emailin personal, po ashtu të deklaruar nga ai vetë gjatë hapjes së profilit.

Pas krijimit të llogarisë, zgjedhësi skanon përmes PER një dokument identifikimi biometrik të lëshuar nga Republika e Shqipërisë (pasaporta ose letërnjoftim) përmes PER, i cili lexon dhe ngarkon automatikisht në PER të dhënat e dokumentit të identifikimit. Nëse këto të dhëna nuk ngarkohen automatikisht, zgjedhësi i ngarkon ato në PER në mënyrë manuale. Më pas, zgjedhësi ngarkon një nga dokumentet që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të parashikimeve të nenit 25, pika 5 të KZ. Lista e dokumenteve që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të miratohet me akt të veçantë të Rregullatorit.

Në fund, zgjedhësi ngarkon në PER të dhënat e kontaktit, që përfshijnë adresën personale të postës elektronike (email), numrin e celularit personal, si dhe të dhënat e adresës së banimit (shtetin, kodin postar, qytetin, emërtesën e rrugës, numrin e banesës, elemente të tjera të adresës nëse ka). Karakteristikat teknike të PER janë të shpjeguara në Lidhjen 1 të këtij projektvendimi.

Në kreun IV të këtij projektvendimi, përcaktohet mënyra e shqyrtimit të kërkesave të ardhura në PER. Pas kryerjes së aplikimit (kërkesës për regjistrim) nga ana e zgjedhësit, përmes ndërveprimit në kohë reale me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC), PER kontrollon saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave të identitetit të zgjedhësit, ato të cilat merren gjenden në dokumentin e identifikimit si emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja etj., për të kontrolluar saktësinë e gjenealiteteve të zgjedhësit me ato në RKGjC. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përmes PER, shqyrton kërkesën për regjistrim të zgjedhësit brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja e saj nëpërmjet PER. KQZ vendos për kërkesën për regjistrim jo më vonë se 5 ditë nga data e depozitimit të saj në PER. Shqyrtimi i kërkesës për regjistrim bëhet si vijon:

- a) PER përmes ndërveprimit në kohë reale me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC), kontrollon saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave të zgjedhësit që u përftuan sipas pikës 7, shkronja “a”, të kreut III, të këtij vendimi;
- b) PER automatikisht verifikon përputhshmërinë e të dhënës biometrike të identifikimit, siç parashikohet në pikën 6 të Kreut III të këtij vendimi, me foton e skanuar nga dokumenti i identifikimit sipas pikës 7 shkronja “a” të Kreut III, të këtij vendimi.
- c) Verifikohet nëse dokumentacioni i cili vërteton adresën e banimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e parashikuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator;
- d) Verifikohet nëse dokumenti i identifikimit i ngarkuar sipas pikës 7 shkronja “a” të Kreut III të këtij vendimi është i vlefshëm.

Nëse kërkesa për regjistrim e zgjedhësit plotëson sa përcaktohet në pikën 2 të këtij Kreu, atëherë zgjedhësi regjistrohet në listën paraprake të zgjedhësve të zgjedhësve nga jashtë. Nëse të paktën një nga kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij Kreu nuk plotësohet, kërkesa për regjistrim e zgjedhësit nuk pranohet. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përmbajë edhe shkaqet e mospranimit. Vendimi mbi shqyrtimin e kërkesës i njoftohet zgjedhësit në llogarinë e tij në PER dhe/ose në adresën e postës elektronike (e-mail) të deklaruar nga ai. Në rastin kur pranohet kërkesa e zgjedhësit për rregjistrimin, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC) vijon me regjistrimin në RKGjC të adresës së zgjedhësit përkatës që voton jashtë vendit në një rubrikë të veçantë. Zgjedhësi të cilit i është refuzuar kërkesa për regjistrim për shkak se dokumenti i tij i identifikimit nuk ka qënë i vlefshëm në momentin kur ai e ka ngarkuar në PER, ai mund ta ripërsërisë kërkesën pa asnjë kufizim në herë deri në ora 24:00 e datës së fundit kur lejohet paraqitja e kërkesave për regjistrim në PER. Në këtë rast zgjedhësit do t'i kërkohet vetëm ngarkimi në PER i dokumentit të identifikimit të vlefshëm. Në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë do të përfshihen vetëm ata zgjedhës të cilët përgjatë periudhës së regjistrimit, që fillon 120 ditë përpara datës së zgjedhjeve e përfundon 63 ditë përpara datës së zgjedhjeve, kanë ngarkuar në PER një dokument identifikimi të vlefshëm. Do të përfshihen gjithashtu në këtë listë edhe ata zgjedhës vlefshmëria e dokumenteve të identifikimit të të cilëve përfundon pas

paraqitjes së kërkesës për regjistrim në PER, por me kushtin që në momentin e paraqitjes së kërkesës dokumenti i identifikimit ka qenë i vlefshëm. Në rast të vështirësive për të realizuar regjistrimin sipas hapave të mësipërm, zgjedhësi mund të ruajë draft kërkesën e tij në PER dhe të kontaktojë për ndihmë teknike lidhur me procesin e regjistrimit, shërbimin e ndihmës që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos në dispozicion të zgjedhësve nga jashtë vendit përgjatë gjithë periudhës së regjistrimit. Vendimi nëse do të përfshihet ose jo në listën paraprake të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit i njoftohet në llogarinë e tij në PER, si dhe në adresën e email të deklaruar në platformë. Afati prej 5 ditësh është përcaktuar si një kohë e arsyeshme për institucionin që të procesojë kërkesat në rastet e periudhave me fluks të madh të kërkesave psh., disa mijëra në ditë. Nëse këto të dhëna nuk janë të sakta, pra nuk janë të njëjta me ato të të RKGjC, PER njofton me mesazh zgjedhësit për saktësimin e tyre dhe deri në korrigjimin e tyre nuk mund të vazhdojë më tej me kërkesën për regjistrim. Zgjedhësi që nuk përfshihet në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë do të ripërfshihet automatikisht në listën e zgjedhësve brenda vendit.

Në kreun V përcaktohen përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, mënyra dhe afatet e komunikimit me RKGjC, si dhe modalitetet e rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste.

Referuar nenit 25, pika 3 e Kodit Zgjedhor, përcaktohet se lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit hartohet dhe përdoret rishtazi për çdo palë zgjedhje për Kuvendin dhe pavarësisht kësaj në çdo rast, KQZ-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ruajnë bazën e të dhënave të zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit për çdo palë zgjedhje. Duke respektuar afatet kufitare për përgatitjen e listës si dhe publikimin e asaj paraprake dhe përfundimtare për zgjedhësit nga jashtë vendit, sipas parashikimeve në nenin 25, pikat 4 dhe 7, të Kodit Zgjedhor në këtë projektvendim janë përcaktuar afatet si vijon:

-Pas përfundimit të afatit për regjistrim, DPGJC nxjerr nga Regjistri (RKGjC) listën paraprake të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe ia dërgon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jo më vonë se 63 ditë para datës së zgjedhjeve.

-Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 63 ditë para datës së zgjedhjeve, publikon listën paraprake të zgjedhësve me qëllim që zgjedhësit brenda 48 orësh nga publikimi i saj mund të kërkojnë regjistrimin apo rregullimin e pasaktësive të regjistrimit të tyre në PER, dhe pas kalimit të afatit për të kërkuar regjistrimin apo rregullimin e pasaktësive në regjistrim, Komisioneri miraton dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të KQZ listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit 60 ditë para datës së zgjedhjeve.

Lista e zgjedhësve pas përfundimit të procesit nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak pas afatit të parashikuar në këtë pikë, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 8 të nenit 25 të KZ, të ndryshuar.

Neni 45 i Kodit Zgjedhor përcakton përbërësit zgjedhorë të listës së zgjedhësve. Në përcaktimin e përbërësve të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit u përdorën për analogji përbërësit e listës brenda vendit të cilët përfshijnë përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “f” të pikës 1 të nenit 45 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, por të përshtatur në kontekstin e votimit nga jashtë ku nuk ka kuptim të flitet për kod banese apo ZAZ dhe në këtë rast si përbërës i kësaj liste është përfshirë shteti i vendbanimit të zgjedhësit që voton jashtë

vendit, i cili gjendet në rubrikën e veçantë në RKGjC ku është regjistruar adresa e zgjedhësit. Në bazë të nenit 25, pika 2 e Kodit Zgjedhor, përcaktohet se lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit është një listë e vetme në nivel zone zgjedhore dhe përmban listën e shtetasve shqiptarë që kanë shprehur vullnetin të votojnë nga jashtë vendit sipas rregullave të përcaktuara në projektvendim dhe që janë regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) në territorin e zonës zgjedhore përkatëse. Në kuadër të kësaj analogjie midis listës së zgjedhësve brenda vendit me atë jashtë vendit, është propozuar në këtë projektvendim që lista e zgjedhësve nga jashtë vendit të përmbajë: emërtimin e zonës zgjedhore, llojin dhe datën zgjedhjeve, përbërësit zgjedhorë të zgjedhësve, sipas përcaktimeve të këtij projektvendimi.

Për të përcaktuar formatet listës së zgjedhësve nga jashtë vendit dhe publikimin e tyre, sërisht është përdorur analogjia me përmbajtjen dhe formatin e listës së zgjedhësve brenda vendit sipas përcaktimeve të nenit 48 të KZ, por i përshtatur në kontekstin e zgjedhjeve nga jashtë vendit. Konkretisht, është përcaktuar listë zgjedhësish në nivel zone zgjedhore dhe në përbërësit zgjedhorë që publikohen në vend të kodit të vendbanimit është parashikuar shteti i vendbanimit jashtë ashtu sikurse lista e zgjedhësve në formë të printuar del e panevojshme në këtë rast prandaj është propozuar vetëm listë në format elektronik për tu publikuar e aksesuar nga zgjedhësit jashtë. Konkretisht, lista e zgjedhësve hartohet në 2 formatet e mëposhtme:

- listë zgjedhësish në nivel zone zgjedhore në formë elektronike për publikim nga KQZ dhe DPGjC, dhe që përmban përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” të nenit 45 të KZ, emërtimin e zonës zgjedhore, llojin dhe datën e zgjedhjeve, si dhe shtetin e vendbanimit të zgjedhësit që voton jashtë vendit i cili gjendet në rubrikën e veçantë në RKGjC ku është regjistruar adresa e zgjedhësit sipas përcaktimeve të këtij projektvendimi;
- përmbledhje e të gjithë zgjedhësve në nivel vendi në formë elektronike për publikim nga KQZ dhe DPGjC me përmbajtje sipas shkronjës “a” të kësaj pike. Zgjedhësit në listë renditen sipas rendit alfabetik të mbiemrit.

Referuar nenit 25, pika 8, e Kodit Zgjedhor, zgjedhësit i njihet e drejta për të paraqitur kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri në 7 ditë para datës së zgjedhjeve, në rastet kur ka paraqitur kërkesë për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit dhe vëren se nuk është i regjistruar në këtë listë, ose regjistrimi i tij ka pasaktësi. Gjykata e shqyrton dhe vendos në lidhje me kërkesën, sipas kësaj pike, brenda 24 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës, por jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve. Emri dhe të dhënat e tjera të zgjedhësit që i shtohet listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit, i bashkëngjitet vendimi i gjykatës.

Në bazë të nenit 56 të Kodit Zgjedhor, shtetasit shqiptarë që janë regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij vendimi, ç’regjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit. Në lidhje me hartimin e listës së zgjedhësve sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 1, të Kodit Zgjedhor, DPGjC harton listën e zgjedhësve duke hequr nga kjo listë emrat e atyre personave që janë të regjistruar në regjistrin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit. Mënyra e bashkëpunimit mes KQZ-së dhe DPGjC-së për çregjistrimin

e shtetasve që votojnë jashtë territorit të RSH në listën brenda vendit do të adresohet me akt të përbashkët midis Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Ministrit përgjegjës për gjendjen civile sipas parashikimeve të nenit 25, pika 13 të Kodit Zgjedhor.

Në kreun VI të projektvendimit parashikohet rregullat që lidhen me mbikëqyrjen dhe kontrollin e procesit të regjistrimit për të siguruar transparencë dhe qasje të të gjithave palëve në çdo hap përgatitor apo të zbatimit të procesit, të tilla si vijon: e drejta e partive politike, organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja të akredituar në Shqipëri, si dhe të medias, të njihen me të gjitha elementët e PER, veçanërisht gjatë proceseve të testimit operacional, kontrollit apo auditimit të së saj, si dhe për të marrë pjesë në testime gjatë procesit të regjistrimit të kërkesave të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të këtij projektvendimi. Auditët teknicienë të miratuar sipas nenit 61, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kryejnë verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit të Komisionit Rregullator për zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit.

### **Bashkëndimi i projektvendimit me palët e interesuara**

Ky projektvendim i është dërguar për mendim përfaqësuesve të partive politike, përfaqësuesve të organizatave të diasporës, organizatave të shoqërisë civile vendase të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, veprimtaria e të cilave ka në fokus zgjedhjet, si dhe medias.

Kanë shprehur mendimet e tyre me shkrim në lidhje me këtë projektvendim, Diaspora për Shqipërinë e Lirë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qëndresa Qytetare, si dhe zj. Anila Smorgrav përfaqësuese e Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD).

Nga opinioni i Diasporës për Shqipërinë e Lirë janë reflektuar në projektvendim parimet e përgjithshme mbi të cilat duhet të mbështetet procesi i regjistrimit.

Nga opinioni i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, të ardhur me shkresën me nr. 2838 Prot., datë 30.09.2024 është shprehur “....projektvendimi është në përputhje me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese me nr. 38/ 2022, por pavarësisht kësaj përputhshmërie, *kushtet dhe dokumentacioni i kërkuar që shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit të realizojnë të drejtën për të votuar, janë të shumta dhe pjesërisht jo vetëm të panevojshme, por edhe të porealizueshme, duke vënë në dyshim realizimin efektiv, të plotë, të saktë të ushtrimit të kësaj të drejte.*”, në këtë relacion është sqaruar se nevoja për të përcaktuar një listë dokumentacioni është parashikuar në nenin 25 pika 5 të KZ, e për sa na takon KQZ është munduar të ofrojë një gamë të gjerë dokumentesh për t’i ofruar zgjedhësit të gjitha mundësitë sa i takon larmishmërisë së dokumentacionit që do të pranohet si i vlefshëm për deklarinimin e adresës.

Në opinionin e saj Qëndresa Qytetare, të ardhur me shkresën nr. 2822 Prot., datë 30.09.2024 është shprehur “...Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes propozimit të Komisionerit e ka



kufizuar edhe më tej të drejtën e votës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke pranuar si dokumente që mund të sigurohen nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të RSH në mënyrë të rregullt, që lidhen me statusin e migrimit të shtetasve.” Një pjesë e konsiderueshme e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kanë status migrimi të paligjshëm, si rrjedhojë nuk mund të sigurojnë kontrata, si ato të qirasë, furnizimit me energji elektrike, ujë apo shërbime internet, të kenë certifikata pronësie apo kontrata kredie bankare”. “..të gjithë dokumentet që parashikohen të përfshihen në listën e dokumentacionit që provon qëndrimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë dokumente në gjuhë të huaj, përmbajtja e të cilave nuk mund të verifikohet pa iu nënshtruar më parë përkthimit... apo duhet të shoqërohen më certifikatën “Apostille”; Qëndresa qytetare gjithashtu parashtron se “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioni Rregullator, të pranojnë si të mjaftueshme për vërtetimin e qëndrimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë edhe vetëdeklarimin e zgjedhësit mbi adresën e saktë të banimit, kundrejt njoftimit të pasojave ligjore që vijnë në rast të deklarimit të pasaktë ose të rremë, sipas Formatit që i bashkëlidhet këtij vendimi”; Në lidhje me sugjerimet e Qëndresës Qytetare për t’u shtuar “vetëdeklarimim e zgjedhësit mbi adresën e saktë të banimit” në listën e dokumentacionit që vërteton qëndrimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, shpjegojmë se nuk mund të pranohet pasi është kërkesë e Kodit Zgjedhor që zgjedhësi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të ketë dokumentacionin për deklarimin e adresës së tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe e njëjta logjikë arsyetimi si në rastin e propozimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit shpjeguar më lart vlen edhe në këtë rast.

Qëndresa Qytetare rekomandon gjithashtu ndryshimin e pikës 3 të kapitullit të tretë, të projektvendimit në si vijon: “Nëse këto të dhëna janë të sakta dhe përputhen me të dhënat që RKGjC ka për këtë zgjedhës, PER regjistron në mënyrë automatike shtetasin si zgjedhës”. Në lidhje me sugjerimin e bërë shpjegojmë se është reflektuar pjesërisht në projektvendim pasi është hequr vendim i Komisionerit rast pas rasti për regjistrimin e çdo zgjedhësi por do të duhet të mbetet shqyrtimi nga ana e administratës pasi së paku do duhet faktori njeri për të parë dokumentacionin e ngarkuar në lidhje me deklarimin e adresës.

Në opinionin e saj zj. Anila Smorgrav, përfaqësuese e Këshillit Koordinues të Diasporës, parashtron në lidhje me nenin që përcakton afatet për regjistrimin e votuese “..duhet një dispozitë që parashikon zgjatjen e afatit në rast të vështirësive teknike me PER. Kjo do të sigurojë që të gjithë votuesit të kenë mundësi të regjistrohen në kohë:. Vlerësojmë se zgjatje të afatit përtej afatit të unifikuar për të gjithë procesin nuk ka sesi të ketë. KQZ do të angazhohet që të procesojë sa më shpejt të jetë e mundur këto kërkesa si dhe në projektvendim (pika 3 dhe 4 të kreut IV) përcaktohet mundësia që zgjedhësi do ketë për të gjurmuar kërkesën e tij si dhe atij do t’i afrohet ndihmë teknike dhe asistencë nga KQZ përgjatë gjithë periudhës së regjistrimit.

Në lidhje me listën e dokumentacionit për të vërtetuar qëndrimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sugjeron ...“pranimin e një deklarate nga ambasada ose konsullata shqiptare si provë e banimit për të mos penalizuar një grup shtetasish që mund të mos kenë mundësi të dokumenteve zyrtare të vendit”. Ezauruar parashtrimi si më lart në rastin e opinionëve për dokumentet e shpjeguara më sipër.

Në lidhje me saktësinë e të dhënave dhe procedurën për korrigjimin e të dhënave në PER, sugjeron se “...duhet të përcaktohet një afat i qartë dhe i arsyeshëm për korrigjimin e të dhënave, duke siguruar që votuesit të kenë mjaftueshëm kohë për të përmirësuar regjistrimin para përfundimit të afateve”. Vlerësojmë se ky afat është i përcaktuar qartë në projektvendim.

Në lidhje me verifikimin e identitetit dhe sigurisë së platformës “PER” sugjeron se “..duhet të përfshihen kërkesa të qarta teknologjike për përdorimin e PER dhe autentifikimin biometrik, si dhe përfshirja e mekanizmave alternativë për ata që kanë probleme teknologjike”. Lidhur me këtë sqarojmë se ky projektvendim është i natyrë rregullatore, detajet teknike përcaktohen në një hap të dytë gjatë implementimit të PER.

Në lidhje me hartimin dhe publikimin e listës së zgjedhësve sugjeron se “ ...duhet të përfshihet një dispozitë për një mekanizëm më të shpejtë për korrigjimin e gabimeve në listën e zgjedhësve përpara finalizimit të listës përfundimtare”. Afati i parashikuar në projektvendim prej 48 orësh vlerësojmë se e ezauron këtë shqetësim.

Në lidhje me kontrollin dhe auditimin e procesit sugjeron “...duhet një plan të detajuar për auditimin dhe testimin e procesit të regjistrimit dhe PER,.. testimi të fillojë sa më herët”. Në lidhje me koordinimin me Institucionet Ndërkombëtare dhe Organizatat e Diasporës sugjeron se “...duhet një rol aktiv për organizatat e diasporës në monitorimin dhe raportimin e procesit të regjistrimit dhe votimit nga jashtë”. Këto vlerësime të përgjithshme janë adresuar në projektvendim përkatësisht në Kreun VI.

Në opinionin e saj, të dërguar me postë elektronike në datën 6.10.24, Partia "Lëvizja Shqipëria Bëhet" ka paraqitur komentet e saj lidhur me rishikimin e afateve në dispozicion të zgjedhësit për të kërkuar saktësim të të dhënave si dhe për afatin e ankimit në Gjykatë pas publikimit e miratimit të listës përfundimtare. Këto sugjerime nuk janë reflektuar për shkak se jaën afate të vendora në Kodin Zgjedhor, të cilat nuk mund të tejkalohen me akt nënligjor.

Organizata KRIIK ka paraqitur rekomendimet e saj me postë elektronike në datën 18.10.2024 të cilat janë reflektuar në këtë projektvendim.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

**Jona JOSIFI - Drejtorja e Votimit nga Jashtë**

**Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)**

**Iirjan Celibashi**  
**Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË  
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË  
ZGJEDHËSVE**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 25, pikat 1 dhe 12, nenit 46, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

**I. Parime të përgjithshme**

1. Parimi i transparencës: Procesi i regjistrimit dhe votimit për zgjedhësit jashtë vendit duhet të jetë i hapur dhe i monitoruar në mënyrë që të garantohet informimi i duhur i publikut dhe subjekteve zgjedhore mbi çdo hap të procedurave.
2. Parimi i thjeshtësisë dhe lehtësisë: Procedurat e regjistrimit dhe të votimit për zgjedhësit jashtë vendit duhet të jenë të thjeshta dhe të lehta për t'u kuptuar e ndjekur nga zgjedhësit, duke minimizuar barrën administrative e teknike, si dhe me kosto sa më të ulët për zgjedhësin.
3. Parimi i efektshmërisë: Procedurat për regjistrimin dhe votimin nga jashtë vendit duhet të jenë efektive, duke synuar që vota e çdo shtetasi të realizohet në kohë dhe pa pengesa të panevojshme.
4. Parimi i gjithëpërfshirjes dhe aksesit të barabartë: Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, pavarësisht vendndodhjes së tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të ketë mundësi të barabarta për të votuar.
5. Parimi i diskrecionit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda kufijve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Diskrecioni ushtrohet në mënyrë që të përmirësohen proceset dhe të adresohen situata të paparashikuara për të garantuar realizimin e votës.

Data: dd mmvvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve

## II. Rregulla të përgjithshme

1. Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet për Kuvendin nga atje ku ndodhet, duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim.
2. Regjistrimi i zgjedhësit në listën e zgjedhësve jashtë vendit bazohet në vullnetin e vetë zgjedhësit për ta ushtruar të drejtën e votës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Regjistrimi në listën e zgjedhësve jashtë vendit passjell çregjistrimin e tij nga lista e zgjedhësve që votojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
4. Regjistrimi i zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit, nga këtu e vijim referuar si zgjedhësi, realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

## III. Rregulla të Posaçme

Procedura dhe afatet për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit.

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton publikisht për hapjen e procesit të hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit dhe regjistrimin e tyre jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të këtij procesi.
2. Zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë paraqet kërkesë për regjistrim në mënyrë individuale në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim. Afati për paraqitjen e kërkesës fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 68 ditë para kësaj date.
3. Kërkesa kryhet përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit, nga këtu e vijim në këtë vendim referuar si “PER” e cila krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. PER duhet ti përcjellë sqarime zgjedhësit në lidhje me procedurat e regjistrimit në listën e zgjedhësve jashtë vendit, si dhe mbi kushtet e kriteret për ushtrimin e të drejtës së votimit nga jashtë vendit. Karakteristikat e përgjithëshme teknike të PER si dhe rregulla të përgjithëshme të përdorimit të tij përcaktohen në aneksin 1 bashkalidhur këtij vendimi. Në çdo rast struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zhvillimin e procedurave përcakton specifikimet teknike për prokurimin e PER.
4. PER është e aksesueshme pa pagesë për zgjedhësin. Zgjedhësit do t'i jepet mundësia ta shkarkojë këtë platformë si në versionin desktop, ashtu edhe në atë mobile pa qenë i kushtëzuar nga lloji i pajisjes elektronike që do të përdorë.
5. Paraqitja e kërkesës për regjistrim në PER bëhet duke krijuar një llogari në këtë platformë nga vetë zgjedhësi. Krijimi i llogarisë dhe hyrja në të, në vijim sipas rastit bëhet nëpërmjet përdorimit të 3 (tre) faktorë autentifikimi.
6. Njëri prej faktorëve autentifikues duhet të jetë biometrik, me njohje të fytyrës (ang. *face recognition*) faktori tjetër është një kod unik i përkohshëm 6 shifror që i dërgohet zgjedhësit në numrin e tij të telefonit mobil dhe/ose email, si dhe faktori i tretë është Numri Personal i Identifikimi (NID) i zgjedhësit dhe fjalëkalimi.
7. Zgjedhësi paraqet kërkesë për tu regjistruar në listën e zgjedhësve nga jashtë, nëpërmjet llogarisë së tij të krijuar në PER, duke ndjekur këto hapa:

- a) Skanon përmes PER një dokument identifikimi biometrik të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, pasaportë për jashtë shtetit, ose letërnjoftim. PER lexon dhe ngarkon automatikisht në platformë të dhënat që përmban dokumenti i identifikimit. Nëse për arsye të ndryshme këto të dhëna nuk ngarkohen automatikisht, atëherë zgjedhësi i ngarkon ato në PER në mënyrë manuale.
  - b) Ngarkon në PER të paktën një dokument që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista e dokumenteve të tillë miratohet me akt të veçantë të Rregullatorit.
  - c) Ngarkon në PER të dhënat e mëposhtme:
    - i. adresën personale të postës elektronike (e-mail) dhe/ose numrin e celularit personal.
    - ii. adresën e banimit e cila duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna: shtetin, kodin postar, qytetin, emërtesën e rrugës, numrin e banesës, si dhe elemente të tjera të adresës (nëse ka).
8. Kërkesa për regjistrim është individuale dhe PER nuk lejon që ajo të paraqitet në emër të një personi tjetër dhe/ose nga një llogari e një personi tjetër.
  9. Me paraqitjen e kërkesës sipas pikës 7 të këtij Kreu, zgjedhësi merr një njoftim automatik nga PER se kërkesa e tij do të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së saj në platformë
  10. PER i ofron mundësinë zgjedhësit që ka paraqitur kërkesën për të ndjekur/gjurmuar statusin e shqyrtimit të saj.

#### IV. Shqyrtimi i kërkesave dhe regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit

1. KQZ vendos për kërkesën për regjistrim jo më vonë se 5 ditë nga data e depozitimit të saj në PER.
2. Shqyrtimi i kërkesës për regjistrim bëhet si vijon:
  - a) PER përmes ndërveprimit në kohë reale me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC), kontrollon saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave të zgjedhësit të cilat u përftuan sipas pikës 7, shkronja “a”, të kreut III, të këtij vendimi;
  - b) PER automatikisht verifikon përputhshmërinë e të dhënës biometrike të identifikimit, siç parashikohet në pikën 6 të Kreut III të këtij vendimi, me foton e skanuar nga dokumenti i identifikimit sipas pikës 7 shkronja “a” të Kreut III, të këtij vendimi.
  - c) Verifikohet nëse dokumentacioni i cili vërteton adresën e banimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e parashikuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator;
3. Nëse kërkesa për regjistrim e zgjedhësit plotëson sa përcaktohet në pikën 2 të këtij Kreu, atëherë zgjedhësi regjistrohët në listën paraprake të zgjedhësve nga jashtë. Nëse të paktën një nga kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij Kreu nuk plotësohet, kërkesa për regjistrim e zgjedhësit nuk pranohet. Vendimi për mospranimin e kërkesës duhet të përmbajë edhe shkaqet e mospranimit.
4. Vendimi mbi shqyrtimin e kërkesës i njoftohet zgjedhësit në llogarinë e tij në PER dhe/ose në adresën e postës elektronike (e-mail) të deklaruar nga ai.

5. Në rastin kur pranohet kërkesa e zgjedhësit për regjistrimin, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC) vijon me regjistrimin në RKGjC të adresës së zgjedhësit përkatës që voton jashtë vendit në një rubrikë të veçantë.
6. Në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë do të përfshihen vetëm ata zgjedhës të cilët përgjatë periudhës së regjistrimit, që fillon 120 ditë përpara datës së zgjedhjeve e përfundon 63 ditë përpara datës së zgjedhjeve, kanë ngarkuar në PER një dokument identifikimi të vlefshëm. Do të përfshihen gjithashtu në këtë listë edhe ata zgjedhës vlefshmëria e dokumenteve të identifikimit të të cilëve përfundon pas paraqitjes së kërkesës për regjistrim në PER, por me kushtin që në momentin e paraqitjes së kërkesës dokumenti i identifikimit ka qënë i vlefshëm.
7. Zgjedhësi që nuk përfshihet në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë do të ripërfshihet automatikisht në listën e zgjedhësve brenda vendit.
8. Në rast të vështirësive për të realizuar regjistrimin sipas hapave të mësipërm, zgjedhësi mund të ruajë draft kërkesën e tij në PER dhe të kontaktojë për ndihmë teknike lidhur me procesin e regjistrimit, shërbimin e ndihmës që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos në dispozicion të zgjedhësve nga jashtë vendit përgjatë gjithë periudhës së regjistrimit

#### **V. Përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, mënyra dhe afatet e komunikimit me RKGjC, si dhe modalitetet e rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste**

1. Lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit është një listë e vetme në nivel zone zgjedhore dhe përmban listën e shtetasve shqiptarë që kanë shprehur vullnetin të votojnë nga jashtë vendit sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim dhe që janë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në territorin e zonës zgjedhore përkatëse.
2. Në listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit, përfshihen të gjithë ata zgjedhës që ju është pranuar kërkesa për regjistrim sipas këtij vendimi.
3. Lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit hartohet dhe përdoret rishtazi për çdo palë zgjedhje për Kuvendin. Në çdo rast, KQZ-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ruajnë bazën e të dhënave të zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit për çdo palë zgjedhje.
4. Përbërësit e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit përfshijnë përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “f” të pikës 1 të nenit 45 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe shtetin e vendbanimit të zgjedhësit që voton jashtë vendit, i cili gjendet në rubrikën e veçantë në RKGjC ku është regjistruar adresa e zgjedhësit sipas përcaktimeve të pikës 2, të kreut IV, të këtij vendimi.
5. Në përfundim të procesit të regjistrimit të kërkesave të zgjedhësve për të votuar nga jashtë vendit, sipas afateve të përcaktuara në pikën 1, të kreut III, të këtij vendimi, DPGjC nxjerr nga RKGjC listën paraprake të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe ia dërgon atë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se 63 ditë para datës së zgjedhjeve.
6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, 63 ditë përpara datës së zgjedhjeve, publikon listën paraprake të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit, me qëllim që zgjedhësit brenda 48 orësh nga publikimi i saj mund të kërkojnë regjistrimin apo rregullimin e pasaktësive të regjistrimit të tyre në PER.
7. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, 60 ditë para datës së zgjedhjeve, miraton dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të KQZ listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit. Lista e zgjedhësve pas përfundimit të procesit nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak

- pas afatit të parashikuar në këtë pikë, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 8 të nenit 25 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
8. Lista e zgjedhësve nga jashtë vendit përmban: emërtimin e zonës zgjedhore, llojin dhe datën e zgjedhjeve, përbërësit zgjedhorë të zgjedhësve, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij kreu.
  9. Lista e zgjedhësve hartohet në formatet e mëposhtme:
    - a) listë zgjedhësish në nivel zone zgjedhore në formë elektronike për publikim nga KQZ dhe DPGjC, dhe që përmban përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” të nenit 45 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, emërtimin e zonës zgjedhore, llojin dhe datën e zgjedhjeve, si dhe shtetin e vendbanimit të zgjedhësit që voton jashtë vendit i cili gjendet në rubrikën e veçantë në RKGjC ku është regjistruar adresa e zgjedhësit sipas përcaktimeve të pikës 4, të kreut IV, të këtij vendimi;
    - b) përmbledhje e të gjithë zgjedhësve në nivel vendi në formë elektronike për publikim nga KQZ dhe DPGjC me përmbajtje sipas shkronjës “a” të kësaj pike.
  10. Zgjedhësit në listë renditen sipas rendit alfabetik të mbiemrit.
  11. Një kopje e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit hartuar sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim i dërgohet nga KQZ Arkivit Qendror të Shtetit jo më vonë se 10 ditë pas miratimit të kësaj liste nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
  12. Kur zgjedhësi që ka paraqitur kërkesë për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit vëren se nuk është i regjistruar në këtë listë, ose regjistrimi i tij ka pasaktësi, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri 7 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore. Gjykata e shqyrton dhe vendos në lidhje me kërkesën, sipas kësaj pike, brenda 24 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës, por jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve. Emri dhe të dhënat e tjera të zgjedhësit që i shtohet listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit, i bashkëngjitet vendimi i gjykatës.
  13. Shtetasit shqiptarë që janë regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij vendimi, çregjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit në përputhje me Aktin e Përbashkët të KSHZ dhe Ministrisë së Përgjithshme për Gjendjen Civile, sipas parashikimeve të pikës 13 të nenit 25 të Kodit Zgjedhor.
  14. DPGJC harton listën e zgjedhësve sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke hequr nga kjo listë emrat e atyre personave që janë të regjistruar në regjistrin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit.

## VI. Mbikqyrja dhe kontrolli i procesit

1. Auditët teknikienë të miratuar sipas nenit 61, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kryejnë verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit të Komisionit Rregullator për zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit.
2. Partitë politike, organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja të akredituar në Shqipëri, si dhe të medias, në kuadër të transparencës dhe



informimit, kanë të drejtë të njihen me të gjitha elementët e PER, veçanërisht gjatë proceseve të: testimi paraprak operacional, kontrollit apo auditimit të saj, si dhe kanë të drejtën për t'u njohur dhe marrë pjesë në testime gjatë procesit të regjistrimit të kërkesave të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të këtij vendimi.

3. Me kërkesë të partive politike, ose kryesisht KQZ, mundëson auditim të pavarur të PER nga subjekte të specializuara.

## **VII. Dispozita të fundit**

1. Ngarkohen administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, për zbatimin e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Ilirjan Celibashi**

**Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**



## **Aneks 1**

### **KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHËSHME TEKNIKE TË PER SI DHE RREGULLA TË PËRGJITHËSHME TË PËRDORIMIT TË TIJ**

#### **I. PËRSHKRIM I HAPAVE TË PROCESIT TË KËRKESAVE DHE SHQYRTIMIT TË TYRE**

- a) Procesi i regjistrimit që do të kryejë zgjedhësi

##### *Hapi I:*

Zgjedhësi shkarkon PER falas, i disponueshëm për sistemet e operimit Android dhe iOS

Ose

Hap adresën/url e disponueshme në website e KQZ nga kompiuteri/laptop/tablet

##### *Hapi II:*

Zgjedhësi skanon dokumentin e identifikimit

PER lexon nga dokumenti këto të dhëna: numrin personal, emrin, mbiemrin, datën e lindjes, foton e dokumentit të identifikimit

##### *Hapi III:*

PER hap kamerën frontale për të bërë 'face recognition' të zgjedhësit e për ta kryqëzuar atë me foton që u skanua nga dokumenti i identifikimit si më lart.

##### *Hapi IV*

PER për të shmangur 'mashtrimet' dhe/ose gabimet; sigurohet se fytyra që është shfaqur në kamera është vetë zgjedhësi dhe jo një fotografi e tij duke përdorur teknologjinë 'user liveness check'.

\* App do ta bëjë këtë verifikim çdo herë kur ai/ajo e përdor atë.

##### *Hapi V*

Zgjedhësit duhet të përcaktojnë nëse kodin 6 shifror (faktori i 3të i autentifikimit) dëshiron ta marrë me email apo me sms në numrin e tij të celularit.

##### *Hapi VI*

Kjo metodë aplikohet menjëherë në këtë moment.

## Hapi VII

Zgjedhësi përfundon regjistrimin duke dhënë këto të dhëna:

-adresën email ose nr. cel;

-adresën e banimit jashtë vendit (sipas fushave të përcaktuara në Vendim). Në këtë rast do duhet të ngarkojë edhe një dokument që provon adresën e banimit jashtë.

## Hapi VIII

PER komunikon në kohë reale me RKGjC për të kontrolluar saktësinë e të dhënave që u përfatuan nga skanimi i dokumentit të identifikimit.

-nëse të dhënat janë të sakta, vijon si në hapin IX.

-nëse të dhënat nuk janë të sakta, PER do ta informojë zgjedhësin se duhet t'i saktësojë ato dhe se nuk do të vazhdojë më tej me regjistrimin derisa ai/ajo t'i korrigjojë ato respektivisht. Ai mund ta vijojë plotësimin e kësaj draft kërkesë në vijim pasi të saktësojë të dhënat. PER do t'i ilustrojë cila fushë/fusha janë identifikuar si të pasakta.

## Hapi IX

Pas verifikimit/konfirmimit si më sipër, zgjedhësi dërgon aplikimin e tij për tu regjistruar dhe menjëherë njoftohet se:

-kërkesa u dërgua me sukses (dritare pop-up dhe/ose email konfirmimi)

-i jepet nr unik i gjurmimit të kërkesës së tij

-ai/ajo do të njoftohet për rezultatin e shqyrtimit të kërkesës nga KQZ brenda afatit përkatës ligjor.

### b. Shqyrtimi i kërkesës nga KQZ

Shqyrtimi i kërkesës për regjistrim bëhet si vijon:

a) PER përmes ndërveprimit në kohë reale me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC), kontrollon saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave të zgjedhësit që u përfatuan sipas pikës 7, shkronja "a", të kreut III, të këtij vendimi; (*verifikim automatik*)

b) PER automatikisht verifikon përputhshmërinë e të dhënës biometrike të identifikimit, siç parashikohet në pikën 6 të Kreut III të këtij vendimi, me foton e skanuar nga dokumenti i identifikimit sipas pikës 7 shkronja "a" të Kreut III, të këtij vendimi. (*verifikim automatik*)

c) Verifikohet nëse dokumentacioni i cili vërteton adresën e banimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e parashikuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator; (*verifikim i KQZ*)


d) Verifikohet nëse dokumenti i identifikimit i ngarkuar sipas pikës 7 shkronja "a" të Kreut III të këtij vendimi është i vlefshëm. (*verifikim i KQZ*)

(a) Nëse këto të dhëna përputhen, KQZ komunikon me DPGjC për përfshirjen e këtij zgjedhësi në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit **dhe** heqjen e tij/saj nga lista e zgjedhësve 'brenda vendit' **për këtë proces zgjedhor**.


Në këtë rast, sistemi i dërgon me e-mail zgjedhësit njoftimin që është përfshirë në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe se është hequr nga lista e zgjedhësve 'brenda vendit'.

(b) Nëse këto të dhëna nuk përputhen, sistemi do të njoftojë zgjedhësin për rezultatin e shqyrtimit dhe arsyet e mospërputhjes/mosregjistrimit. Pas kësaj njoftimi, ai/ajo mund të paraqesë ankesë sipas dispozitave në aktet përkatëse të miratuar nga KQZ për këtë qëllim.

c. *Paraqitja grafike e hapave për tu ndjekur nga zgjedhësi dhe nga KQZ*

Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri |  | info@kqz.gov.al | kqz.gov.al | +355 4 4510810

PROCESI REGJISTRIMIT	SHQYRTIMI I KËRKESËS
<ul style="list-style-type: none"><li>● Zgjedhësi shkarkon PER ose Hap adresën e disponueshme në website e KQZ nga PC</li><li>● Zgjedhësi skanon dokumentin e identifikimit. PER lexon nga dokumenti : numrin personal, emrin, rmbiemrin, datën e lindjes, foton e dokumentit të identifikimit</li><li>● PER hap kamerën frontale 'face recognition' të zgjedhësit</li><li>● PER sigurohet se fytyra në kamera është vetë zgjedhësi dhe jo ndonjë foto e tij - 'user liveness check'.</li><li>● Zgjedhësit duhet të përcaktojnë nëse kodin 6 shifror dëshiron ta marrë me e-mail apo me sms në numrin e tij të celularit</li><li>● Zgjedhësi përfundon regjistrimin duke dhënë këto të dhëna :<ul style="list-style-type: none"><li>• e-mail ose nr. cel</li><li>• adresën e banimit jashtë vendit. Në këtë rast duhet ngarkuar dhe një dokument që provon adresën e banimit jashtë</li></ul></li><li>● PER komunikon në kohë reale me RKGjC për të kontrolluar saktësinë e të dhënave që u përfutuan nga skanimi i dokumentit</li><li>● Pas verifikimit/konfirmimit, zgjedhësi dërgon aplikimin e tij për tu regjistruar dhe menjëherë njoftohet se :<ul style="list-style-type: none"><li>• kërkesa u dërgua me sukses</li><li>• i jepet një numër unik i gjurmimit të kërkesës së tij</li><li>• ai/ajo do të njoftohet për rezultatin e shqyrtimit të kërkesës nga KQZ brenda afatit ligjor</li></ul></li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>● Përmes ndërveprimit në kohë reale me RKGjC, kontrollohet saktësia dhe përputhshmëria e të dhënave të zgjedhësit</li><li>● PER automatikisht verifikon përputhshmërinë e të dhënës biometrike të identifikimit me foton e skanuar nga dokumenti i identifikimit</li><li>● Verifikohet nëse dokumentacioni i cili vërteton adresën e banimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e parashikuara</li><li>● Verifikohet nëse dokumenti i identifikimit i ngarkuar është i vlefshëm</li><li>● Nëse këto të dhëna përputhen, KQZ komunikon me DPGjC për përfshirjen e zgjedhësit në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit</li></ul>

Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri |  | info@kqz.gov.al | kqz.gov.al | +355 4 4510810

## II. PËRSHKRIM I PLATFORMËS ELEKTRONIKE TË REGJISTRIMIT (PER)

PER duhet të ketë dy module kryesore:

- *Moduli i regjistrimit*, ku zgjedhësi bën kërkesën për regjistrim dhe verifikon identitetin;
- *Moduli i menaxhimit të kërkesave*, ku KQZ shqyrton dhe verifikon informacionin e paraqitur nga zgjedhësit.

Këto module do të mundësojnë një proces të sigurt dhe të besueshëm për menaxhimin e votave të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

## III. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE TË PLATFORMËS ELEKTRONIKE TË REGJISTRIMIT TË VOTUESVE NGA JASHTË

**PER duhet të plotësojë minimalisht kërkesat teknike si më poshtë:**

- Mundësi regjistrimi përmes një aplikacioni ëeb si dhe aplikacioni mobile;
- Mbledhje e të dhënave të gjeneralitetit, biometrike dhe atyre të dokumentave fizike;
- Të jetë në gjendje të kap një foto “selfie” të qytetarit për ta ruajtur në sistemin qendor të menaxhimit të identitetit. Për të siguruar cilësinë e selfie-t, aplikacioni në internet dhe aplikacioni i portofolit digjital duhet të lehtësojnë dhe optimizojnë procesin e kapjes së fotos;
- Të kryejë kontrollin e ‘liveness’ dhe të krahasojë fotografinë e marrë me fotografinë e profilit të siguruar nga një ID fizike e vërtetuar;
- Të lexojë automatikisht të dhënat nga dokumenti i identifikimit.
- Të kapë imazhe të të dy anëve të dokumenteve fizike të identifikimit. Sistemi duhet të ketë aftësinë të vërtetojë dokumentin fizik të identifikimit duke verifikuar karakteristikat e dokumentit, si fotot, shpërndarjen e informacionit, strukturën, regjistrimet, kodet dy dimensionale dhe nënshkrimet e të dhënave për dokumentet e bazuara në NFC, ndër të tjera;
- Të përfshijë një motor njohje që ndihmon zgjedhësin të pozicionojë saktë dokumentin e identifikimit brenda një kornize, të rregullojë imazhin për të siguruar këndin dhe cilësinë e kërkuar, dhe të kapë automatikisht imazhin e dokumentit;
- Të lejojë nxjerrjen automatike të informacionit nga dokumenti fizik i identifikimit dhe leximin e kodeve dy dimensionale të barrave për të krahasuar informacionin e koduar me të dhënat e printuara;
- Nxjerrja e informacionit nga dokumentet fizike të identifikimit duhet të bëhet përmes *Njohjes Optike të Karaktereve (ang. OCR)*;
- Të lejojë nxjerrjen e fotografive (nga dokumentet e vlefshme të identifikimit fizik) dhe krahasimin me selfien e qytetarëve për të verifikuar pronësinë e dokumentit;
- Sistemi duhet të kërkojë adresën e emailit të aplikantit ose numrin celular dhe të përdorë një fjalëkalim një herë për të konfirmuar informacionin e kontaktit të dhënë nga aplikanti;
- Sistemi duhet të kërkojë adresën e plotë të votuesit jashtë vendit sipas fushave të paracaktuara (shteti, qyteti, etj.);

- Sistemi duhet të lejojë ngarkimin e një dokumenti si provë të adresës. Verifikimi i adresës do të bëhet nga operatori/nëpunës KQZ nga moduli i Menaxhimit të Kërkesave;
- Sistemi duhet të përfshijë gjeolokalizimin e aplikantit në momentin e aplikimit si pjesë e informacionit të kërkesës;
- Aplikacioni i portofolit digjital duhet të jetë i disponueshëm dhe pa pagesë në Google Play dhe App Store në Shqipëri dhe në mbarë botën;
- Portofoli digjital duhet të jetë në gjendje të skanojë dokumente me madhësi të ndryshme dhe t'i ruajë ato në portofol;
- Funksionaliteti bazë i portofolit duhet të funksionojë offline: kapja e dokumenteve, nxjerrja e të dhënave, paraqitja e dokumenteve;
- Të përdorë protokollin e Sigurisë së Shtresës së Transportit (TLS) 1.2 për të siguruar komunikimet me platformën e menaxhimit të institucionit të besueshëm;
- Të ketë mekanizëm të kontrollit të aksesit biometrik (njohje e fytyrës);
- Mekanizëm për bllokimin e aksesit nëse bëhen disa përpjekje të pasuksesshme për hyrje;
- Zgjidhja duhet të jetë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi që lidhen me ruajtjen e të dhënave të zgjedhësve. Të gjitha informacionet e të dhënave të përdoruesve duhet të mbeten në pajisjet e përdoruesve dhe në një qendër të dhënash të menaxhuar nga KQZ;
- Arkitektura e zgjidhjes mund të përdorë një qasje cloud për përpunimin e të dhënave nëse të dhënat përpunohen në Shqipëri ose BE. Ruajtja e të dhënave të qytetarëve duhet të bëhet në datacenterin e KQZ të ndodhur në Shqipëri;
- Sistemi duhet të lejojë operatorët/stafin e KQZ të shqyrtojnë aplikimet e marra dhe të pranojnë, refuzojnë, ose të kërkojnë më shumë informacion;
- Kur një aplikim refuzohet, operatori/stafi i KQZ duhet të japë një nga arsyet e paracaktuara për refuzimin dhe kjo duhet të komunikohet tek kërkuesi;
- Kur një operator/stafi i KQZ zgjedh të kërkojë më shumë informacion, duhet të specifikohet qartë në mesazh se cili informacion shtesë duhet të sigurohet;
- Zgjedhësi duhet të njoftohet për ndryshimet e statusit të aplikimit të tij;
- Njoftimet do të dërgohen në adresën e email-it dhe/ose numrin celular të dhënë nga zgjedhësi gjatë procesit të aplikimit si dhe PER;
- Kur një aplikim është shqyrtuar dhe miratuar, sistemi do të dërgojë një njoftim që informon aplikantin për regjistrimin e suksesshëm;
- Kur një aplikim është shqyrtuar dhe kërkohet më shumë informacion, sistemi do të dërgojë një njoftim duke kërkuar informacionin shtesë dhe duke ofruar një lidhje për dorëzimin e tij;
- Kur një aplikim është shqyrtuar dhe refuzuar, sistemi do të dërgojë një njoftim duke informuar aplikantin për refuzimin dhe duke ofruar arsyen.;
- PER duhet të sigurojë një portal menaxhimi për të kontrolluar përdoruesit administrator;
- Për të aksesuar modulën e Menaxhimit të Kërkesave, zgjidhja duhet të lejojë autentifikimin me 2 (dy) faktorë përmes hyrjes, fjalëkalimit dhe OTP-së;
- Moduli i Menaxhimit të Kërkesave duhet të mbyllë sesionin e përdoruesit nëse nuk ka aktivitet për një periudhë të paracaktuar kohe;
- Portali duhet të jetë në gjendje të menaxhojë role të ndara për grupe të ndryshme përdoruesish;

**Iirjan Celibashi**  
**Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**